



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 29 Prot.

Tiranë, më datë 18.012023

VENDIM

Nr. 3, datë 18.01.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saç”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.01.2023:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim Koncept-Idenë Paraprake për projektin “Prezantimi/ Interpretimi dhe Valorizimi i Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin, Banjave Romake dhe i Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe Itinerari i Vizitorëve”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues “SON Engineering Construction” dhe zhvillues Ministria e Kulturës dhe AADF;
2. Gjatë procesit të hartimit të projekt idesë, projektuesi të rakordojë me projektin “Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit”;
3. Të hartohet raporti mbi Vlerësimin Për Ndikimin Në Trashëgiminë Kulturore për projektin e propozuar;
4. Gjatë procesit të hartimit të projekt idesë, projektuesi duhet të marrë në konsideratë sugjerimet si vijon:
 - a. Për strukturën lëvizëse “People Mover” të merret në konsideratë impakti minimal vizual në monument dhe në pjesën e nëntokës;
 - b. Projektuesi pas marrjes së rezultateve të sondazheve apo gërmimeve arkeologjike të sjellë rakordimin e strukturës së shkallareve;
 - c. Lartësia e strukturës së shkallareve t’i referohet lartësisë që ka pasur Amfiteatri;
 - d. Projekti duhet të marrë në konsideratë që strukturat e shërbimeve e propozuara (nyjet h/sanitare, biletari, etj.) të përballojnë fluksin e parashikuar të vizitorëve, i cili duhet të paraqitet në një studim të hollësishëm;
5. Të gjitha tabelat informuese, orientuese dhe shpjeguese duhet të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

7. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elva MARGARITI



SEKRETAR

Eugen KALLFANI